



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVA – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT,
SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

MINISTRY OF EDUCATION,
SCIENCE & TECHNOLOGY

MINISTARSTVO ZA OBRAZOVANJE
NAUKU I TEHNOLOGIJU

Kabineti i Ministrët

Office of the Minister

Kabinet Ministra

UDHËZIM ADMINISTRATIV

NUMER:17/2004

DATA:16.06.2004

LËNDA: KONVIKTET E NXËNËSVE DHE TË STUDENTËVE

Në bazë të nenit 1.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/19 mbi Degën e Ekzekutivët të Institucioneve të Përkohshme të Vetqeverisjes në Kosovë , dhe sipas nenit 42 të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm , Ministria e Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë (më tutje MASHT) përmes këtij Udhëzimi rregullon çështjen në vijim:

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim ta përcaktojë statusin dhe veprimtarinë e konvikteve, të drejtat e obligimet e nxënësve dhe të studentëve (në tekstin e mëtejshëm: konviktorëve), të strehuar në konvikte.

Neni 2

Statusi

Konviktet e nxënësve dhe të studentëve (në tekstin e mëtejshëm: konviktet) janë institucione publike edukativo-arsimore, të cilat janë në shërbim të konviktorëve.

Neni 3

Puna në konvikte

- 3.1. Puna në konvikte është publike.
- 3.2. Mënyra e realizimit të punës publike në konvikte rregullohet në mbështetje të Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë, të Statutit të konviktit dhe akteve tjera pozitive, deri në nxjerrjen e Ligjit mbi konviktet e nxënësve dhe të studentëve.

Neni 4

Veprimtaria

- 4.1. Konvikti, si institucion shërbyes , me rëndësi të veçantë shoqërore, u siguron konviktorëve vendosjen, ushqimin, punën kulturore dhe mbrojtjen shëndetësore.
- 4.2. Konviktorëve u sigurohen kushtet për jetë dhe punë normale.

Neni 5

Puna edukativo shërbyese

- 5.1. Punën edukativo shërbyese në konvikte e udhëheq drejtori i cili zgjidhet nga MASHT, sipas procedurave të Rregullorës nr. 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës .
- 5.2. Në punën edukative shërbyese mund të angazhohen edhe bashkëpunëtorët profesional të cilët punojnë punë të veçanta në interes të institucionit të konviktit dhe konviktorëve.
- 5.3. Në konvikte bëhet planifikimi i punës edukative shërbyese dhe i aktiviteteve të lira të konviktorëve gjatë një viti shkollor.
- 5.4. Punët sipas nenit 5.3 dhe kriteret për vlerësimin e punës, përcaktohen me programin vjetor të punës së konvikteve.

Neni 6

Drjtori

- 6.1. Drejtori duhet të jetë personi i cili e ka të mbaruar fakultetin për mësimdhënie.
- 6.2. Profili i bashkëpunëtorëve profesional përcaktohet me Normativin mbi Kuadrin Profesional të Shkollave të Mesme.

Neni 7

Konviktorët

Konviktorët, janë nxënës dhe studentë të rregullt, të cilët i vijnë mësimet në shkolla të mesme të larta apo fakultete publike të rajonit përkatës respektivisht të komunës.

Neni 8

Pranimi i konviktorëve

- 8.1. Konviktorët pranohen sipas konkursit me kriteret të caktuara nga MASHT-
- 8.2. Pranimin e konviktorëve e bënë ZRA në bashkëpunim me Këshillin e Konviktit.
- 8.3. Në Këshillin e Konviktit duhet të jenë së paku dy (2) përfaqësues të studentëve respektivisht nxënësve.

Neni 9

Viti shkollor

- 9.1. Viti shkollor në konvikte fillon me 1 shtator dhe mbaron me 30 qershor.
- 9.2. Pas këtij afati konviktorët e humbin statusin e banuesit të rregullt.
- 9.3. Konviktorët mund t'i shfrytëzojnë shërbimet e konviktit edhe pas 30 qershorit varësisht nga nevoja për përgatitjen e provimeve.

Neni 10

Të drejtat

10.1. Konviktorët kanë të drejtë:

- (a) t'i shfrytëzojnë të gjitha të mirat të cilat u ofron shërbimi i konviktit,
- (b) ta formojnë Këshillin e Nxënësve dhe të Studentëve
- (c) të formojnë shoqëri dhe klube për t'i realizuar qellimet e tyre edukative, kulturore, etj

Neni 11

Obligimet

11.1. Konviktorët janë të obliguar që:

- (a) t'i ruajnë dhe të kujdesen për të gjitha pajisjet që u ofron shërbimi i konviktit,
- (b) të sillen konform rregullave të konviktit,
- (c) t'i kryejnë me kohë obligimet e tyre të participimit,
- (d) në fund të vitit t'i dorëzojnë të gjitha pajisjet me të cilat kanë qenë të ngarkuarë,

Neni 12

Mbikqyrja

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë, e bënë mbikqyrjen e ligjëshmërisë dhe të punës së gjithëmbarëshme në konvikte.

Neni 13

Financimi

13.1. Financimi i konvikteve bëhet nga:

- (a) Ministria e Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë,
- (b) të ardhurat e realizuara nga participimi i konviktorëve dhe
- (c) nga të ardhurat tjera.

Neni 14

Participimi

- 14.1.** Lartësinë e participimit të konviktorëve e përcakton Ministria e Arsimit , Shkencës dhe Teknologjisë në propozim të Këshillit të Konviktit.
- 14.2.** Të ardhurat sipas nenit 13.1.c. mund të shfrytëzohen me lejen paraprake të Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë..

Neni 15

Sistemimi

- 15.1.** Këshilli i Konviktit i propozon Ministrisë së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë, sistemimin e vendeve të punës.
- 15.2.** Drejtori i konviktit e bënë përshkrimin e punëve për secilin vend të punës.

Neni 16

Hyrja në fuqi

- 16.1.** Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi me rastin e nënshkrimit .
- 16.2.** Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, çfuqizohen aktet tjera të cilat e kanë rregulluar më parë këtë fushë.

Rexhep Osmani,
Ministër